

**VENDIM**  
**Nr. 100/2018**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017,**  
**“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE**  
**KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË**  
**KUALIFIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rrvlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Lidhja nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2, “Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2, “Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 4.10.2018

## ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

| FUNKSIONI ORGANIK                                                                      | Klasifikimi i pagës                             | Numri     |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|-----------|
| <b>KRYETARI</b>                                                                        |                                                 | (2)       |
| <b>I. KRYETAR</b>                                                                      | G3*                                             | 1         |
| Sekretar                                                                               | Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit** | 1         |
| <b>II. KOMISIONERËT</b>                                                                | G3*                                             | (11)      |
| <b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>                                                  |                                                 | (24)      |
| Këshilltarë juristë                                                                    | 80% e pagës G3*                                 | 12        |
| Këshilltarë ekonomistë                                                                 | 80% e pagës G3*                                 | 12        |
| <b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>                                                     | I-a                                             | 1         |
| <b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b> |                                                 | (16)      |
| Drejtor                                                                                | II-b                                            | 1         |
| Specialist sekretarie gjyqësore                                                        | III-b                                           | 6         |
| Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve                                    | IV-a                                            | 2         |
| Përkthyes                                                                              | II-b                                            | 5         |
| Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë                                      | III-a                                           | 1         |
| Specialist pritjeje me popullin                                                        | IV-a                                            | 1         |
| <b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>                            |                                                 | (10)      |
| Drejtor                                                                                | II-b                                            | 1         |
| Specialist financë/buxhet                                                              | III-b                                           | 1         |
| Specialist i burimeve njerëzore                                                        | III-b                                           | 1         |
| Specialist IT ***                                                                      | III-b                                           | 1         |
| Specialist protokoll/arkivi ****                                                       | IV-a                                            | 2         |
| Magaznier                                                                              | VII                                             | 1         |
| Punonjës pastrimi                                                                      | III                                             | 2         |
| Shofer/korrier                                                                         | VI                                              | 1         |
| <b>TOTAL</b>                                                                           |                                                 | <b>64</b> |

*Shënim.*

\* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

\*\* Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\*\* Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune, në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\*\*\* Punonjësit në pozicionet specialist arkivi përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

\*\*\*\*\* Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

**Strukturë organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

